

Tiranë, më_07, _07__, 2021

Drejtuar:

Lënda: Kërkesë për informacion mbi të dhënat/dokumentacionin, që disponon Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

E nderuar znj. Demiraj,

Fondacioni “Së bashku” vepron që prej vitit 2013 në Shqipëri dhe drejtohet nga të rinj me aftësi të kufizuar, ku objektivi i punës së tij është mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar nën moton “Asgjë për ne, pa ne” dhe fuqizimi i tyre.

Aktualisht, Fondacioni ka aplikuar në thirrjen e organizuar nga Bashkimi Evropian, për fondin social dhe ka kaluar fazën e parë të përzgjedhjes. Ky projekt nëse do të kalojë dhe fazën finale do të zbatohet në Bashkitë Krujë dhe Gjirokastrë. Në kuadër të sa më sipër, na nevojitet informacion në lidhje me disa aspekte të rëndësishme për përfshirjen dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Bazuar në ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe VKM Nr. 708, datë 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor” përcaktohet se institucionet shtetërore përgjegjëse¹ duhet të administrojnë të dhënat si më poshtë vijon:

- Numri i personave me aftësi të kufizuar të regjistruar si punëkërkues të papunë pranë zyrave të punësimit;
- Numri i personave me aftësi të kufizuar të punësuar nga zyrat e punësimit;
- Numri i personave me aftësi të kufizuar të punësuar në subjekte private, ndarë sipas gjinisë;
- Numri i personave me aftësi të kufizuar të punësuar nga programi specifik për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuar, ndarë sipas gjinisë;

¹ Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Fondi i programuar në buxhetin e shtetit për nxitjen e punësimit për personat me aftësi të kufizuar;
 - Fondi i shpenzuar për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, nga programi specifik për nxitjen e punësimit;
 - Numri i zyrave të punësimit të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar;
 - Numri i qendrave të arsimit profesional të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar;
-



-
- Numri i personave me aftësi të kufizuar që ndjekin kurse profesionale. Të ndarë sipas: grupmoshës; gjinisë; vendbanimit (urbane/rurale); llojit të kursit profesional.
 - Numri i personave me aftësi të kufizuar që punësohen pas përfundimit të kurseve profesionale

Nisur nga sa më sipër, kërkojmë informacionin e sipërpërmendur për dy bashkitë/qarqet Krujë e Gjirokastrë dhe nëse Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka:

- Dokumente/strategji/plane veprimi/marrëveshje bashkëpunimi etj. me subjektet private në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuar;
- Modele pozitive/praktika të mira të zhvilluara, mbi përfshirjen e punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të marrjes së informacionit nga ana juaj.